

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtarës së vetëme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.D. nga fsh....., K. e, për shkak të veprës penale dëmtimi i pasurisë së luajtshme nga neni 260 parag. 1 i KPK-së, duke vendosur sipas propozim akuzës së PPK-së nga Gjilani PP.nr.640/2012 të dt.23.04.2012, në shqyrtimin e mbajtur gjyqësor në prezencën e Prokurores së Shtetit Rozelida Hasani, të akuzuarit R.D. si dhe mbrojtësit me autorizim av.E.C. më dt.02.12.2014 komunikoi, ndërsa më dt.12.12.2014 përpiloi këtë,

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i ,

R.D., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i dënuar një herë më parë për vepër penale, ndërsa nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

ë s h t ë f a j t o r

Më datë 14.04.2012, rreth ores 15.30, në, në parkingun e taksistëve, pas një mosmarrëveshje në mes të N.B. e R.D., rreth parkingut të veturave, I pandehuri R.D. me dashje dëmton pasurinë e laujtshme të të dëmtuarit N.D., në atë mënyrë që duke ditur se syzat e lëna mbi bagazh janë të të dëmtuarit N.B. i gjuan në tokë i then duke i shkelur me këmbë.

- me çka ka kryer veprën penale dëmtimi i pasurisë së luajtshme nga neni 260 parag. 1 të KPK-së.

Andaj gjykata duke u mbështetur në nenin 4,41,50,51,52,73,75 dhe nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarit, i shqipton

Dënim me kusht

Ashtu që të akuzuarit, i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, ekzekutimi i të cilit dënim nuk do të bëhet nëse i akuzuari mbrenda afatit prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në rast se i akuzuari kryen vepër tjetër penale, mbrenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg.

I dëmtuari N.B. ngapër realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Gjiilan, me propozim akuzën PP.nr.640/2012 të dt.23.04.2014, ka akuzuar R.D. nga f.sh., K. e, për shkak të veprës penale dëmtimi i pasurisë së luajtëshme nga neni 260 par.1 të KPK-së, pran të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin.

I akuzuari R.D. në mbrojtjen e tij nuk ka kontestuar faktin se me dt. 14.04.2012 në parkingun e taksistëve në ka pasur një mosmarrëveshje me N.B. përshkak të parkimit të veturës, në momnetin e parkimit të veturës N.B. nuk ishte në veturë i cili ndërkohë ka ardhur dhe ka dashur të më sulmoj te vetura ime, pasi këtë nuk e ka lejuar N.B.ka marrë në veturën e tij një lopatëz të vogël e ka hapur derën e veturës me forcë dhe e ka goditur në këmbën e majtë nën gju ku i ka shkaktuar lëndime, R.D. ka marrë kaqavidën dhe ka dalur nga vetura për tu mbrojtur, në këtë situatë ka ndërhyrë dhe i ka ndar N.H., ka gjetur syzet e tij para veturës por jo të thyera, pas tërë kësaj ngjarje ka pasur pasagjer për ti dërguar deri në dhe pasi ka pasur dhimbje është lajmëruar tek mjeku, i akuzuari mohon të ketë parë syze të dëmtuara, apo ti ketë thyer syzet me këmbë të ofruara nga N.H., i akuzuari në mbrojtëjen e tij gjithëashtu ka deklaruar se është e mundur ti ketë shkelur syzet e N.B. mirëpo nuk i kujtohet a ka pasur fare syze aty. Në fjalën përfundimtare i akuzuari nuk e ndien vehtën fajtor dhe kërkon nga gjykata që ta liroj nga përgjegjësia penale.

Mbrojtësi me autorizim av. E.C. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, nuk është kontestuese se ditën kritike ka pasur mosmarrëveshje në mes të të akuzuarit dhe personit N.B. , ku në këtë mosmarrëveshje i pandehuri R.D. ka qenë i sulmuar dhe i goditur me një mjet të rrezikshëm për shëndetin nga N.B. ku edhe i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, sipas provave të shtjelluara del se në rastin konkret janë thyer një parë syze vlera e të cilave nuk është përcaktuar, syzat nuk janë sjellur si korpusdelikt, andaj konsiderojm se kemi të bëjmë me një vepër të rëndësisë së vogël ku sipas nenit 11 të KPRK-së nuk është vepër penale vepra e rëndësisë së vogël , po që se gjykata gjen se vepra penale ekziston atëherë kemi të bëjmë me nenin 13 te KPRK-së, (nevoja ekstreme) ku i akuzuari R.D. duke u mbrojtur nga sulmet ka mundur rastësisht ti ketë shkelur ato syze edhe pse kategorikisht mohohet nga i akuzuari, andaj pasi vepra penale nga neni 260 par. 1 kryhet me dashje e jo nga pakujdesia i propozojm gjykatës konform nenit 364 par. 1 pika 1.2 të KPRK-së i pandehuri të lirohet nga përgjegjësia penale

Gjykata në procedurën provuese dëgjuar dëshmitarët si dhe ka bërë leximin e provës materiale bashkangjitur lëndës si: raportin e hetimeve me nr. 2012-CB-131, dt. 14.04.2012.

Dëshmitari S.G. në dëshminë e tij ka deklaruar,. Pas marrjes së informatës nga baza kanë dalur në vend të ngjarjes te parkingu i taksistëve në, pasi aty ka ndodhur një mosmarrëveshje në mes taksistëve, rastin e ka lajmëruar N.B. në këtë rast kanë qenë të involvuar N.B. e R.D.i, fillimisht kanë

kontaktuar me N.B. ndërsa R.D. nuk e kanë takuar pasi i njëjti ishte nisur në drejtim të me pasagjer, në vend ngjarje personalisht i ka parë syzet e thyera të cilat kanë qenë tërësisht të dëmtuara të shkelura me këmbë dhe të njëjta syza janë identifikuar nga N.B. se janë syzet e tij, ndërsa R.D. ka pasur një gërvishje në këmbë, nga dëshmitarët në vend të ngjarjes jemi njoftuar se syzet i ka thyer qëllimisht R.D., syzet kanë qenë me dioptri ndërsa vlera e tyre sipas ankuesit ka qenë prej 180-200 euro.

Dëshmitari N.H. në dëshminë e tij ka deklaruar, në ditën kritike pas dite nuk i kujtohet ora, ka qenë i parkuar në parkingun e taksistëve ku ka ndëgjur një zhurmë dhe ka parë një përlëshje në mes R. dhe N. pas ndërhyrjes të njëjtit i ka ndarë dhe pas ndarjes secili ka shkuar në drejtim të vetë, N. ka pasur në dorë ashov (lopatëz e vogël) ndërsa R. ka pasur kaqavidë, në momentin e ndarjes asnjëri nuk e ka goditur veturën e njërit tjetërit, dëshmitari pasi i ka parë syzat në tokë i ka lënë mbi veturën e R. dhe pasi i ka ndarë të njëjtit, R. i ka thyer syzet, dëshmitari mbetet pranë deklaratës dhënë në polici më dt 14.04.2012 dhe deklaron se është në gjendje të ballafaqohet për gjithëqka çka obligohet nga ligji.

Nga shkresat e çështjes dhe nga provat që janë proceduar në këtë çështje penale juridike, nuk janë kontestuese faktet: se më dt. 14.04.2012 në parkingun e taksistëve në ka pasur një mosmarrëveshje në mes të taksistëve N.B. e R.D. rreth parkimit të veturave, gjykata nga dëshmia e dëshmitarit N.H. vërtetoi faktin se pas përlëshjes në mes N.B. e R.D. dëshmitari ka ndërhyrë dhe i ka ndarë, pas ndarjes i njëjti dëshmitarë ka parë në tokë një palë syze, duke menduar se janë syzet e R. i ka marrë dhe i ka lënë mbi bagazh të veturës së R., mirëpo R. duke ditur se syzet janë të N.B. i ka përplas në asfalt, i ka shkelur me këmbë dhe dëmtuar, po ashtu edhe nga deklarata e dëshmitarit S.G. gjykata vërtetoi faktin se në vend ngjarje (në parkingun e taksistëve) personalisht ka parë syzet e thyera të shkelura me këmbë të cilat sipas informatave që ka pasur syzet kanë qenë të N.B., vërtetimin e fakteve të cekura më lartë në një mënyrë e pöhon edhe i akuzuari kur deklaron se nuk më kujtohet por është e mundur se i kam shkelur syzet e N.B..

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit mirëpo mbrojtësjësë tij gjykata nuk ia fali besimin pasi e konsideron të pa bazuar dhe këtë e ka bërë me qëllim që t'i shmanget përgjegjësisë penale për veprën për të cilën akuzohet.

Nga faktet që u parashtruan më parë, qartë rezulton se janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale dëmtim i pasurisë së luajtshme nga neni 260 paragrafi 1 të KPK-së.

Me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ndaj të akuzuarit për veprën penale që e ka kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, ndikojnë që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rëndë, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori: sjelljen korrekte në gjykatore, mbajtës i familjes, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale, bashkëpunues me gjykatën ndërsa rrethana veçanarisht rënduese ndaj ti nuk gjeti. Për këtë arsye kjo

Gjykatë vlerëson se në rrethana të tilla edhe vetëm kërcënimi me dënim, është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit në segmentin prevencionit individual dhe gjeneral .

I dëmturi N.B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil, konform nenit 463 të KPRK-së,

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450 të KPPRK-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

Më datën 12.12.2014, 102/2014

Procesmbajtësja

Gjyqtarja

Emine Zubaku,d,v

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej
15 ditësh nga dita e pranimi të aktgjykimit, Gjykatës së
Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.